



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 34, Datë 04.02.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 54, DATË 22.02.2021

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 5, gërma “ç”; 6 dhe 7 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 5.1, gërma “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 02.02.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 484, seria T21, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.02.2021.
- Me vendimin e bordit nr. 112, datë 23.05.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.
- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.06.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.
- Rezulton se i licencuari “GERTI” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: *Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.*
- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: *për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën ç) të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.*
- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të

dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të neneve 5, gërma “ç” dhe 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017.
- Neni 6 i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikon se: *në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.*
- Në nenin 7 të Rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 484, seria T21, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “GERTI” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.02.2021.
2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI